



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 maj 2020
Nr. Ref.:RK1567/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI31/19

Parashtrues

Shpresa Ferati-Duraku

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës
Supreme Rev. nr. 387/2018 të 5 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shpresa Ferati-Duraku nga Mitrovica (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Safet Voca, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 387/2018 të 5 dhjetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 paragrafi 1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 paragrafi 1 (E drejta për zgjidhje efektive), nenin 17 paragrafi 1 (Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave), si dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) paragrafi 2 të Protokollit Shtesë nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 25 shkurt 2019, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 8 mars 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtrueses për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 15 janar 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 nëntor 2013, Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Qendra Kryesore për Mjekësinë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF “Dr. Nexhat Çuni”), në Mitrovicë, shpalli në gazetën e përditshme “Lajm” një konkurs publik për praninë të një punëtori në vendin e punës ndihmës në depo në QKMF “Dr. Nexhat Çuni”.

10. Në bazë të shkresave të lëndës, rrjedh se parashtruesja e kërkesës kishte aplikuar në konkursin e shpallur.
11. Më 17 dhjetor 2013, Komisioni Përzgjedhës shpalli rezultatet e konkursit, në bazë të të cilave, parashtruesja e kërkesës kishte arritur rezultatet më të mira gjatë intervistës.
12. Më 16 prill 2014, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë së Komunës së Mitrovicës i dërgoi njoftimin Ref. 10 - 031 - 12998, Këshillit Drejtues të QKMF-së “Dr. Nexhat Çuni“, në të cilin ajo kërkoi që konkursi të anulohet për shkak të *“dyshimeve ne objektivitetin e komisionit si dhe procedurat e shpalljes së konkursit”*.
13. Më 8 maj 2014, Këshilli Drejtues i QKMF “Dr. Nexhat Çuni“ mori vendimin për anulimin e konkursit. Gjithashtu, njoftimi për anulimin e konkursit iu dërgua edhe parashtrueses së kërkesës. Në njoftim thuhet:

“Me zbatimin e njoftimit të Drejtorisë Komunale për Shëndetësi Ref /10 - 031 - 12998 të datës 16.04.2014, përmes të cilit jemi obliguar ta anulojmë konkursin e datës 16.11.2013, të shpallur në gazetën “Lajm” Departamenti i Administratës dhe Personelit i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ju njofton se anulohet konkursi sipas njoftimit obligativ të cekur më lart nga DKSH për pozitën.”
14. Më 28 maj 2014, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë kundër njoftimit për anulim të konkursit pranë Komisionit për ankesa, duke pretenduar se vendimi i Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë në Mitrovicë është i padrejtë dhe i kundërligjshëm *“ngase është në kundërshtim flagrant me dispozitat përkatëse të Ligjit të Punës së Kosovës”*.
15. Më 6 qershor 2014, Komisioni për ankesa mbajti seancë për të shqyrtuar ankesën e parashtrueses së kërkesës. Po të njëjtën ditë, Komisioni për ankesa mori vendim me të cilin refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera thuhet:

“Drejtoria e Shëndetësisë me qëllim të eliminimit të dyshimeve në objektivitetin e komisionit si dhe procedurat e shpalljes së konkursit të datës 16.11.2013 konsideron se procedurat nuk janë konformë dispozitave në fuqi, andaj mori vendim që këtë konkurs ta anuloj...”
16. Ndërkohë, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë në Mitrovicë dhe QKMF “Dr. Nexhat Çuni” përsëri shpallën konkurs për të njëjtin vend pune, në të cilin parashtruesja e kërkesës nuk konkurroi, siç thuhet në kërkesë *“duke konsideruar se është pranuar në mënyrë të rregullt e ligjore”*.
17. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kundër Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe QKMF “Dr. Nexhat Çuni”, me të cilën kërkoi *„anulimin e vendimit për anulimin e konkursit dhe vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës.”*

18. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë mori Aktgjykimin C. nr. 321/2014, me të cilin pranoi kërkesëpadinë e parashtrueses, anuloi vendimin e QKMF “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë, të 8 majit 2014 dhe e detyroi të paditurën t’i mundësojë paditëses (parashtrueses së kërkesës) të nënshkruajë kontratën e punës bazuar në rezultatet e konkursit të 16 nëntorit 2014. Në aktgjykim, Gjykata Themelore konkludoi se: *“parashtruesja e kërkesës është diskriminuar me procedurën e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe QKMF “Dr. Nexhat Çuni”, e cila është në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit të punës”*.
19. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë në Mitrovicë dhe QKMF “Dr. Nexhat Çuni” parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit C. nr. 321/2014, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 18 shtator 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 501/15, me të cilin e aprovoi si të bazuar ankesën e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe QKMF “ Dr. Nexhat Çuni”. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata e Apelit e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e hodhi poshtë padinë e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit theksoi:
- a) *Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitat nga neni 5 i Ligjit të Punës, të cilat dispozita i referohen ndalimit të të gjitha llojeve të diskriminimit..., gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se mosdhënia e mundësisë që paditësja ta nënshkruajë kontratën e punës kualifikohet në kuadër të dispozitave që i referohen diskriminimit.*
 - b) *Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, se veprimet e të paditurës për anulimin e vendimit me të cilin paditësja është përzgjedhur kualifikohen në kuadër të dispozitave që i referohen diskriminimit, sepse në paragrafi 1 të nenit 5 të Ligjit të Punës përcaktohet se: „Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi”, e që sipas kësaj dispozite nuk rrjedh se veprimet e të t'paditurës kualifikohen si diskriminuese.*
 - c) *Dispozita e sipërcituar përcakton se diskriminimi është i ndaluar edhe me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës, mirëpo në rastin konkret mos nënshkruarja e kontratës së punës për paditësen nuk mund të kualifikohet si diskriminim, pasi që e paditura ka zbatuar procedurën e rregullt të përcaktuar me aktet e saj të brendshme.*
21. Parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, C. nr. 501/15, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, shkelje të dispozitave të nenit 31, paragrafit 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

22. Më 5 dhjetor 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 387/2018, me të cilin kërkesa për revizion e parashtrueses së kërkesës u refuzua si e pabazuar. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Supreme theksoi:

“[...] gjykata e shkallës së dytë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se veprimet e të paditurës nuk kualifikohen si diskriminuese, ashtu qysh janë përcaktuar në dispozitën e nenit 5 .1 të Ligjit të Punës, ngase në rastin konkret mos nënshkruarja e kontratës së punës për paditësen nuk mund të kualifikohet si diskriminim.

Thëniet e revizionit të paditëses se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2 të LPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me shkresat e lëndës, në aktgjykimin e kundërshtuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, duke nxjerrë konkludime të cilat në tersi i aprovon edhe kjo Gjykatë.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës i ka dy grupe të pretendimeve. Në grupin e parë përfshihen pretendimet në lidhje me procedurën që ajo zhvilloi në administratën komunale në Mitrovicë, ndërsa në grupin e dytë përfshihen pretendimet në lidhje me procedurën gjyqësore që ajo zhvilloi në gjykatat e rregullta.
24. Sa i përket grupit të parë të pretendimeve, parashtruesja e kërkesës konsideron se me veprimet e saj “Komuna e Mitrovicës, drejtpërdrejt ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 5, paragrafi 1 i Ligjit të Punës, në lidhje me nenin 24 të Kushtetutës – Barazia para Ligji, si dhe nenin 1, par. 2 të Protokollit Nr. 12, të KEDNJ – me të cilin ndalohet diskriminimi”.
25. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se Komuna e Mitrovicës ka shpërdoruar të drejtat që është në kundërshtim me nenin 17 (Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave) të KEDNJ-së, duke shkelur kështu nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.
26. Sa i përket grupit të dytë të pretendimeve, parashtruesja e kërkesës së pari pretendon se ajo është viktimë e diskriminimit të gjykatave të rregullta, sepse ato nuk morën parasysh deklaratën e bërë në seancën dëgjimore nga avokati N.Q., i cili përshkroi në detaje procedurën e shpalljes së konkursit, si dhe rrjedhën e zgjedhjes së kandidatëve dhe procedurën e nënshkrimit të kontratës.
27. Më tej, parashtruesja e kërkesës konsideron se “shkelja e dispozitave kushtetuese nga Gjykata e Apelit ekziston për faktin se kjo gjykatë pa të drejtë

konstaton se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar nenin 5 par. 1 të Ligjit të Punës, dhe e njejtat me asnjë fjalë të vetme nuk e arsyetojn këtë qëndrim të tyre juridik, për më tepër, pa kurrfar baze juridike dhe arsyetimi ligjërish të qëndrueshëm“.

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me një Aktgjykim të tillë të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 par. 1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.
29. Parashtruesja e kërkesës konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka shqyrtuar rastin sipas dispozitave ligjore dhe kushtetuese, dhe nuk ka mbrojtur të drejtat e saj të punës dhe ushtrimit të profesionit. *“Gjykata Supreme me vendimin e vet ia ka mohuar të drejtën e saj të punës, pa kurrfar baze juridike dhe arsyetimi të qëndrueshëm dhe te bazuar ligjërish“.*
30. Në thelb, parashtruesja kërkon nga Gjykata që ta shqyrtojë kërkesën e saj dhe të konstatojë se janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 24, 32 dhe 49 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me nenet 6, 13, 17 dhe 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) paragrafi 2 të Protokollit Shtesë nr. 12 të KEDNJ-së. Në pajtim me këtë, të anulohen Aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe të Apelit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë të shpallet i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“*
33. Për më tepër, Gjykata i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

“Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar e cila konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin Rev. nr. 387/2018 të Gjykatës Supreme të 5 dhjetorit 2018, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
35. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] paragrafit (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
36. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata konstaton se ajo në thelb konsideron se të drejtat e saj kushtetuese dhe të drejtat e garantuara me KEDNJ, janë shkelur nga administrata komunale në Mitrovicë me vendimin për anulimin e konkursit në të cilin ajo mori pjesë. Po ashtu, gjykatat e rregullta, konkretisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, vazhduan me shkeljen e të drejtave të saj kur nxorën Aktgjykimet për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
37. Gjykata duke pasur parasysh se procedurat dhe veprimet e administratës komunale në Mitrovicë, si dhe vendimi i marrë lidhur me anulimin e konkursit, që tanimë ishin objekt i kontrollit gjyqësor, e gjen të nevojshme që në këtë rast të merret vetëm me vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat parashtruesja e kërkesës i lidh me shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 24

[Barazia para Ligjit], nenin 31 paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 paragrafi 1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës si dhe të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 6 paragrafi 1 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 paragrafi 1 (E drejta për zgjidhje efektive), nenin 17 paragrafi 1 (Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) paragrafi 2 i Protokollit Shtesë Nr. 12 të KEDNJ-së.

38. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka ngritur disa pretendime lidhur me shkeljen e disa neneve të Kushtetutës dhe neneve të KEDNJ-së, megjithatë, Gjykata gjithashtu konstaton se në thelb të gjitha ato pretendime për shkelje të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së rezultojnë nga fakti se ajo mendon se nuk ka pasur gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Gjykata në vazhdim, së pari do të shqyrtojë pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe pastaj të gjitha pretendimet e tjera që mund të rezultojnë si pasojë e shkeljes së kësaj të drejte.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

39. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se ajo konsideron se nuk ka pasur gjykim të drejtë për faktin se gjatë procedurës gjyqësore ajo nuk ka mundur të ushtrojë të drejtat e saj, sepse së pari Gjykata e Apelit dhe më vonë Gjykata Supreme gabimisht e kanë zbatuar/interpretuar nenin 5 paragrafin 1 të Ligjit të Punës.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren, para së gjithash, se procedura në fjalë ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave civile të parashtrueses së kërkesës, më konkretisht të drejtën e punës në kërkesëpadinë e parashtruar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë. Prandaj, në rastin konkret, bëhet fjalë për një çështje të një natyre civile-juridike, nga e cila rrjedh se mund të zbatohen neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së.
41. Gjykata rikujton se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në pjesën përkatëse thekson:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
42. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, i cili në pjesën relevante thekson:
- “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj... .”*
43. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, konkretisht të nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, Gjykata thekson

se është si rregull i përgjithshëm, që pretendimet për interpretimin e gabuar të dispozitave të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, në rastin konkret të nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, përkatësisht, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KIO6/17, parashtrues i kërkesës *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; dhe rastin KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56).

44. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57).
45. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Ruisisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
46. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana në të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritetet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet në lidhje me interpretimin e ligjit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
47. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndër marrë masa kur vëren se një gjykatë ka “zbatuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës (shih, në këtë drejtim, rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83 dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës KIO6/17,

parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, cituar më lart, paragrafi 40 dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59).

48. Duke i sjellë pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës ka iniciuar procedurën kontestimore në Gjykatën Themelore në lidhje me vendimin e administratës komunale në Mitrovicë, me të cilin është anuluar konkursi për punësim. Gjykata gjithashtu konstaton se Gjykata Themelore e anuloi atë vendim të administratës komunale duke konkluduar *“se ishte në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës”*.
49. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se neni 5 paragrafi 1 i Ligjit të Punës rregullon çështjen e Ndalimit të diskriminimit në punësim, i cili thotë:

“1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.”
50. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në procedurën ankimore Gjykata e Apelit, duke i trajtuar pretendimet ankimore, ka konkluduar se Gjykata Themelore ka zbatuar gabimisht dispozitën e nenit 5 paragrafin 1 të Ligjit të Punës, që ka të bëjë me ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit. Gjykata e Apelit konstatoi se *“Duke u nisur nga gjendja faktike e konstatuar në procedurën e të provuarit, e përshkruar si më lartë, përkatësisht si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se mosdhënia e mundësisë që paditësja ta nënshkruajë kontratën e punës kualifikohet në kuadër të dispozitave që i referohen diskriminimit”*.
51. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata e Apelit në aktgjykim ka dhënë edhe një shpjegim konkret përse ajo konsideron se Gjykata Themelore ka zbatuar gabimisht nenin 5 paragrafin 1 të Ligjit të Punës, duke konstatuar që *“Dispozita e sipërcituar përcakton se diskriminimi është i ndaluar edhe me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës, mirëpo në rastin konkret mos nënshkruarja e kontratës së punës për paditësen nuk mund të kualifikohet si diskriminim, pasi që e paditura ka zbatuar procedurën e rregullt të përcaktuar me aktet e saj të brendshme”*.
52. Për më tepër, nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit nxori konkludimin e saj se parashtruesja e kërkesës nuk është viktimë e diskriminimit nga fakti se ajo kurrë nuk kishte nënshkruar kontratë pune me palën e paditur dhe, rrjedhimisht, ajo nuk kishte themeluar marrëdhënie të punës. Rrjedhimisht, diskriminimi si i tillë nuk mund të kishte ndodhur për shkak se veprimi i thjeshtë i mos-nënshkrimit të kontratës në vetvete nuk prodhon efekte juridike dhe as detyrime ndërmjet dy palëve në të ardhmen.
53. Sa i përket procedurës në Gjykatën Supreme, Gjykata vëren se në procedurën e revizionit, ajo kishte trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtrueses së kërkesës, dhe kishte dhënë arsyetimin e saj për secilin pretendim ankimor.

54. Gjykata thekson në veçanti faktin se Gjykata Supreme ka trajtuar edhe pretendimet ankimore të parashtruese në lidhje me pretendimin se administrata komunale i kishte keqpërdorur të drejtat, gjë që ishte në kundërshtim me nenin 17 të KEDNJ-së dhe që, si rezultat, kishte ardhur deri te diskriminimi i hapur dhe i drejtpërdrejtë, që është në kundërshtim me nenin 5.1 të Ligjit të Punës dhe nenin 1.2 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Gjykata Supreme arriti në përfundimin se *„veprimet e të paditurës nuk kualifikohen si diskriminuese, pasi që e njëjta ka vepruar duke zbatuar procedurën e rregullt të akteve të brendshme të saj, e cila e drejtë i takon të paditurës lidhur me përzgjedhjen e kandidatit duke respektuar procedurën e rekrutimit në bazë të udhëzimit administrativ”*.
55. Për më tepër, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme është marrë edhe me pretendimin ankimor të parashtrueses së kërkesës në lidhje me deklaratën e bërë nga avokati gjatë seancës dëgjimore, të cilën, sipas pretendimeve të saj, gjykatat nuk e morën parasysh. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme konkludoi: *“pretendimet tjera të revizionit, lidhur me deklaratën e juristit të QKMF dhënë në seancën e datës 16.12.2018, ... [...] kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike për të cilën në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK -ës revizioni nuk mund të paraqitet”*.
56. Në dritën e sa më sipër, Gjykata konstaton se nuk ka gjetur asgjë që në rastin konkret do të tregonte se rregullat materiale-juridike në rastin konkret ishin zbatuar në mënyrë arbitrare ose të padrejtë në dëm të parashtrueses së kërkesës. Gjykata gjithashtu konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ofron fakte që do të mund ta justifikonin pretendimin se ka shkelje të të drejtave kushtetuese në të cilat ajo thirret, dhe për këtë shkak nuk ka elemente që tregojnë *prima facie* se mund të ketë shkelje të të drejtave kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafin 1 të KEDNJ-së dhe se do të duhej shqyrtim meritor.

Pretendimet për shkelje të nenit 49 paragrafit 1 të Kushtetutës

57. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, nga fakti që gjykatat nuk e kanë anuluar vendimin e administratës komunale në Mitrovicë për anulimin e konkursit, për çfarë asaj i pamundësohet që të punojë.
58. Gjykata thekson që neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës thotë:
- “1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”*
59. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se dispozita e nenit 49 të Kushtetutës parasheh **i)** të drejtën e çdo personi që të mund të punojë dhe **ii)** të drejtën që, çdo person në përputhje me vullnetin e tij të lirë, dëshirën, kualifikimin, aftësinë, mund lirisht të zgjedhë një profesion dhe një vend pune.

60. Gjykata dëshiron veçanërisht të theksoj që neni 49 i Kushtetutës, nuk i garanton askujt të drejtën për punë dhe të drejtën e një personi për të punuar në një vend specifik të punës.
61. Gjykata duke i vënë në lidhje pretendimet e parashtrueses së kërkesës me arsyetimet e vendimeve të kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme, konstaton se autoriteti kompetent ka shpallur dhe më pas ka anuluar konkursin, në pajtim me rregulloret e saj të brendshme, që do të thotë se parashtruesja e kërkesës as që kishte nënshkruar ndonjëherë kontratën e punës, dhe prandaj, as nuk e kishte themeluar marrëdhënien e saj të punës me të paditurën. Prandaj, të drejtat të cilat ajo pretendon se i janë shkelur, si të tilla, nuk mund të lindin në kuptimin juridik. Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit dhe të punëdhënësit lindin vetëm pas nënshkrimit të kontratës së punës, me ç’ rast zbatohen edhe dispozitat e Ligjit të Punës.
62. Përveç kësaj, Gjykata nga shkresat e lëndës gjen se administrata komunale në Mitrovicë, kishte shpallur sërish konkurs për të njëjtën pozitë, gjë që mund të konkludohet se parashtruesja e kërkesës në çdo moment gjatë kohëzgjatjes së konkursit ka pasur mundësi që të aplikojë në të njëjtin konkurs, dhe se nuk ekzistonte asnjë vendim i autoritetit administrativ ose gjyqësor me të cilin do të ndalohej aplikimi i sërishëm i saj në konkursin e hapur.
63. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës janë te pabazuara.

Pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14, dhe nenin 1 paragrafi 2 të Protokollit Shtesë nr. 12 të KEDNJ-së

64. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se ajo ishte diskriminuar për shkak se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, kishin anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore me të cilin ishte konkluduar se vendimi i administratës komunale në Mitrovicë ishte diskriminues. Nga kjo rrjedh se diskriminimi kundër saj vazhdon edhe me vendimet e gjykatave të rregullta.
65. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës ankohet për shkelje të së drejtës për mosdiskriminim sipas nenit 24 të Kushtetutës, nenit 14 të KEDNJ-së, dhe nenit 1 paragrafi 2 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
66. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës në pjesën përkatëse thekson:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike,

sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
[...].”

67. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, i cili në pjesën përkatëse thekson:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

68. Gjykata gjithashtu rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për mosdiskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ-së është një e drejtë shtesë. Kjo do të thotë se ky nen nuk siguron një të drejtë të pavarur dhe autonome për mosdiskriminim, por në diskriminim sipas këtij neni mund të thirret vetëm në lidhje me *“gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga KEDNJ”*. Ndonëse konstatimi i shkeljes së të drejtave të garantuara nuk është një parakusht për zbatimin e nenit 14 të KEDNJ-së, megjithatë, ky nen nuk do të mund të zbatohet nëse faktet e rastit në fjalë nuk bien *“në kuadër”* të të drejtave të garantuara (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë*, i 18 korrikut 1994, Seria A numër 291-B, paragrafi 22).

69. Në rastin konkret, Gjykata tashmë ka konstatuar se parashtrueses së kërkesës nuk i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për ç’arsye pretendimet e saj nuk bien brenda fushëveprimit të këtyre neneve, ashtu që nuk mund të zbatohet neni 14 i KEDNJ-së.

70. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që Gjykata Supreme, në një pjesë të veçantë të aktgjykimit të saj, i kushtoi vëmendje të posaçme kësaj çështjeje, dhe me këtë rast konkludoi se pretendimet e saj për diskriminim ishin të pabazuara.

Pretendimet për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së

71. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës se gjatë procedurës gjyqësore asaj i ishte shkelur edhe e drejta nga neni 32 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së, Gjykata rikujton që neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës në pjesën përkatëse thekson:

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

72. Gjithashtu, neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, në pjesën relevante thekson:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar,

pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

73. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se efikasiteti/efektiviteti i mjeteve juridike në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së nuk përcaktohet në bazë të asaj nëse parashtruesi i kërkesës me shfrytëzimin e tyre ka arritur t'i realizojë qëllimet e tij në mënyrën se si ai kishte dashur, por nëse ai kishte pasur mundësinë që me mjetin juridik që ai e shfrytëzon të mund të paraqesë argumentet e tij që do të shqyrtohen nga autoritetet kompetente (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar* seria A nr. 161, i 7 korrikut 1989, paragrafi 120).
74. Duke marrë parasysh faktet e rastit konkret, që parashtruesja e kërkesës kishte përdorur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj pranë autoriteteve administrative të Komunës së Mitrovicës dhe gjatë procedurës së rregullt gjyqësore, çon në konkludimin se pretendimet e saj për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së janë të pabazuara.
75. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata thekson se është obligim i parashtrueses së kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e saj kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, i 5 dhjetorit 2013).
76. Prandaj, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 janar 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese,



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi